



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOSARKAŠKI SAVEZ KOSOVA



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA
BASKETBALL FEDERATION OF KOSOVO

Nr. 148 Dt. 09.03.2023
PRISHTINË • PRIŠTINA • PRISTINA

Federata e Basketbollit
të Kosovës

+383 49 738 080

federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Faza 2
Str: Radovan Zogoviq
10 000 Prishtina

Bazuar në Rregulloren për Punën e Komisionit Arbitrar të FBK-së, Propozicioneve të Garave për Kategoritë Seniore (Edicioni 2022/2023), si dhe në bazë të Ankesës së KB Vëllaznimi të datës 08.03.2023, Komisioni Arbitrar i FBK-së, me datë 09.03.2023 merr këtë:

VENDIM

- I. Shpallet e PRANUESHME kërkesa e KB Vëllaznimi e datës 08.03.2023;
- II. APROVOHET ankesa e KB Vëllaznimit e datës 08.03.2023 si e BAZUAR;
- III. KTHEHET NË RIVENDOSJE pika 1 e Vendimit Nr.14/2023 të Komisionit të Garave.
- IV. DETYROHET Komisioni i Garave që Ankesën e KB Vëllaznimi ta shqyrtojë në aspekt meritator.

ARSYETIM

Me datë 08.03.2023, Komisioni Arbitrar, përmes postës elektronike, ka pranuar Ankesën e KB Vëllaznimit të datës 08.03.2023 (tash e tutje: "Ankesa"), konform nenit 43 të Propozicioneve të Garave të FBK-së. Kjo e fundit ka të bëjë me pikën 1 të Vendimit Nr.14/2023 të Komisionit të Garave të FBK-së (tash e tutje: "Vendimi").

Në këtë kuadër, Komisioni Arbitrar ka mbajtur takim më 09.03.2023, dhe ka trajtuar Ankesën e KB Vëllaznimit. Në takim kanë qenë prezent: Korab R. Sejdiu (Kryetar i Komisionit Arbitrar), Lulzim Fushtica (Anëtar i Komisionit Arbitrar), Fidan Hamiti (Anëtar i Komisionit Arbitrar), u.d. Sekretari i Përgjithshëm i FBK-së dhe Këshilltarja Ligjore për Sport e FBK-së.

Sipas kuptimit të Komisionit Arbitrar, KB Vëllaznimi në Ankesë sfidon pikën 1 të Vendimit Nr.14/2023, sipas së cilës Komisioni i Garave refuzoi ankesën e KB Vëllaznimit pas ndeshjes me KB Sigal Prishtinën (xhiro XXIV).

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



TEB

Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOSARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit
të Kosovës

+383 49 738 080

federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Faza 2
Str: Radovan Zogoviq
10 000 Prishtina

Komisioni Arbitrar gjatë trajtimit të lëndës ka shqyrtuar të gjitha dokumentet përkatëse dhe provat në dispozicion, dhe ka konstatuar si në dispozitiv, për arsyet në vijim.

Komisioni Arbitrar vlerëson se Vendimi Nr.14/2023 i Komisionit të Garave nuk e trajton në mënyrë adekuate ankesën nga KB Vëllaznimi.

Arsyetimi i ankesës së KB Vëllaznimit drejtuar Komisionit të Garave ka prekur dy pika kryesore:

1. KB Sigal Prishtina ka regjistruar dy lojtarë të natyralizuar (lojtari i dytë ka zhvilluar ndeshjen ndaj KB Vëllaznimit), dhe kjo nuk është në përputhje me nenin 31 të Rregullores për Regjistrim dhe Kalim në FBK, i cili përcakton se *"çdo skuadër ka të drejtën e paraqitjes për regjistrim vetëm 1 (një) lojtar të natyralizuar nga FBK."*; dhe
2. Lojtari i dytë është regjistruar jashtë afatit të regjistrimit të paraparë me nenin 31 të Rregullores për Regjistrim dhe Kalim në FBK.

Në anën tjetër, Komisioni i Garave, në arsyetimin e pikës 1 të Vendimit Nr.14/2023, ka marrë parasysh faktet në vijim:

1. Në Vendimin Nr.13/2023 Komisioni i Garave ka vendosur që lojtarit Rezart Memedi ti njihet statusi i lojtarit vendor të natyralizuar. Rrjedhimisht Komisioni konstaton se rreth statusit të lojtarit Rezart Memedi ka vendosur një herë. Komisioni i Garave nuk mund ta shqyrtojë si shkallë e dytë vendimin e vet. Nisur nga ky parim dhe jo nga përmbajtja e ankesës dhe faktet e dërguara nga KB Vëllaznimi, Komisioni ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Bazuar në faktet e lartpërmendura, Komisioni Arbitrar ka konstatuar se, gjatë vendimmarrjes lidhur me pikën 1 të Vendimit Nr.14/2023, Komisioni i Garave ka anashkaluar pikën 1 të ankesës nga KB Vëllaznimi (gjegjësisht regjistrimin e dy lojtarëve të natyralizuar nga KB Sigal Prishtina), dhe ka refuzuar ankesën me arsyetimin se statusi i njërit prej lojtarëve veçse është shqyrtuar (pa trajtuar meritat e ankesës).

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



TEB

Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOSARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit
të Kosovës

+383 49 738 080

federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Faza 2
Str: Radovan Zogoviq
10 000 Prishtina

Prandaj, Komisioni i Garave detyrohet të rishqyrtojë ankesën e KB Vëllaznimit në aspektin meritor, dhe kështu të trajtojë edhe përmbajtjen e ankesës dhe faktet e dërguara nga KB Vëllaznimi.

Rrjedhimisht, Komisioni Arbitrar duke u mbështetur në atë që u tha më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Komisioni Arbitrar:

Fidan Hamiti
Anëtar

Korab R. Sejdiu
Kryetar

Lulzim Fushtica

Lulzim Fushtica
Anëtar

Prishtinë, 9 Mars 2023

Vendimi i dërgohet:

- KB Vëllaznimi
- Komisionit të Garave
- Anëtarëve të Komisionit Arbitrar
- Arkivit të FBK-së



Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



TEB

Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:

